



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**

**Nr. 531, datë 28.10.2020**

**PËR**

**MIRATIMIN E MODELIT TË HARTIMIT TË “RAPORTIT ANALITIK PËR  
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147 pika 1 shkronja “a” të Kushtetutës, nenet 68-72, 90 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.264 datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e modelit të hartimit të “Raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Modeli i këtij raporti analitik miratohet në formatin shkresor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor .

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**